



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1463/1 Prot.

Tiranë, më 20.07.2026

VENDIM

Nr. 57 Datë 20.07 2026

“PËR

RAPORTIN E GRUPIT TË PUNËS, NGRITUR ME URDHHRIN E REKTORIT TË UST "PËR NGRITJEN E GRUPIT TË PUNËS PËR VERIFIKIMIN E PROCEDURËS SË NDJEKUR PËR NXJERRJEN DHE EKZEKUTIMIN E URDHRAVE NR. 47, DATË 15.05.2026, "PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALESËN E PAGESAVE TË KRYERA PËR KATEGORINË ASISTENT LEKTOR" DHE NR. 62, DATË 03.06.2026, "PËR MARRJEN E MASAVE PËR NDALESËN E PAGESAVE TË KOMISIONEVE NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË AUDITIT TË BRENDSHËM”

Mbështetur në nenin 49 të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor IAL, në Republikën e Shqipërisë", në neni 43 të Statutit të UST-së, në nenin 24 të Rregullores së Universitetit të Sporteve të Tiranës, në shkresën nr. 3021/36 Prot., datë 16.07.2026 Raport i grupit të punës ngritur me Urdhrrin nr. 21, datë 14.07.2026 të Rektorit të UST "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e procedurës së ndjekur për nxjerrjen dhe ekzekutimin e urdhrave nr. 47, datë 15.05.2026, "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë asistent lektor" dhe nr. 62, datë 03.06.2026, "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm", Raportin e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Arsimit protokolluar në UST me nr. 3021/5 Prot., datë 02.04.2026, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 108, datë 13.07.2026 "Për mbështetjen e kërkesave të parashtruara në peticionin me nr.3021/32 datë 10.07.2026", në Vendimin e Senatit Akademik nr. 111 datë 17.07.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 20.07.2026,

V E N D O S I :

1. Të mos miratojë pikën 1 (një) të Vendimit të Senatit Akademik nr. 111 datë 17.07.2026 lidhur me Raportin e Grupit të Punës mbi verifikimin e procedurës së ndjekur për nxjerrjen dhe ekzekutimin e urdhrave nr. 47, datë 15.05.2026, "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë asistent lektor" dhe nr. 62, datë 03.06.2026, "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të auditit të brendshëm" (bashkëlidhur).
2. Të miratojë pikën 2 (dy) të Vendimit të Senatit Akademik nr. 111 datë 17.07.2026 lidhur Shfuqizimin e Urdhrit nr. 47, datë 15.05.2026 "Për marrjen e masave për ndalesën e pagesave të kryera për kategorinë Asistent Lektor" dhe të Urdhrit nr. 62, datë 03.06.2026 "Për marrjen e

masave për ndalesën e pagesave të komisioneve në zbatim të rekomandimeve të Auditit të Brendshëm".

3. Të ngihet një grup pune i drejtuar nga Administratori , dhe i përbërë nga anëtarë të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, Drejtorisë Juridike dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit. Ky grup pune të kryejë një hetim administrativ lidhur me Vendimet që ka marrë Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit për punonjësit e kategorisë "Asistent lector" paguar si Lektorë dhe pagesat e Komisioneve , objekte të Raportit të Auditimit.
4. Ky Vendim i përcillet për zbatim Administratorit të Universitetit të Sporteve të Tiranës, dhe për njohje Senatit Akademik të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

